



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 31  
Prishtinë, 10 shkurt 2009, ora 11: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Bujar Bukoshi dhe Qamile Morina.

Mungoi: Slllobodan Petroviq

Të pranishëm:

Nga AKPM-ja (Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale): Zehadin Gashi- kryeshef ekzekutiv,  
Nga “New Co-Farmakosi”: Azem Lajçi – pronar,  
Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore,  
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati,  
Nga KDI-ja: Fitore Zeneli,  
Nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës: Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

*Komisioni i zhvilloi punimet me këtë*

**REND DITE**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Takim me përfaqësues të Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale dhe përfaqësues të „New – Co Farmakosit”**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Teuta Hadri** – Pati vërejtje lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi. Është mbajtur dëgjim publik dhe ky ligj është dashur të hynte në rend të ditës, si pikë kryesore për këtë mbledhje.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.*

## 3. Takim me përfaqësues të Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale dhe me përfaqësues të „New – Co Farmakosit”

**Sadik Idrizi** - Tha se Komisioni në mbledhjen e kaluar vendosi të dëgjohen përfaqësuesit e Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale dhe përfaqësuesit e fabrikës „New – Co Farmakos”, lidhur me rilicencimin e kësaj fabrike. Komisioni parlamentar nuk ka të drejtë të vendosë për këtë çështje, por mund të jap rekomandim. New – Co Farmakosi është privatizuar para disa vjetësh. Deri më tani nuk ka pasur asnjë rast të ankesës për produktet e tij dhe për veprimet kundëririndikative të prodhimeve të tij. Vlen të përmendet fakti se kjo kompani i ka të punësuar rreth 50 punëtorë. E hapi diskutimin.

**Azem Lajçi** – Tha se Farmakosi është rilicencuar çdo vit. Ka aplikuar (më 17. 09. 2008) për rilicencim, dy ditë para se të kalonte licenca. Procesi i inspektorëve është shumë tendencioz. Inspeksioni nuk është i kualifikuar për ta dhënë vlerësimin që e ka bërë. Nuk është zbatuar Ligji në fuqi nr.2003/26, pika v, sepse nuk ka akt plotësues normativ për GNP-në, të paraparë në këtë ligj. Sipas Ligjit në të gjitha fabrikat evropiane ose botërore, që aplikojnë për t’i regjistruar preparatet në AKPM, inspektorët e kanë për detyrë ta bëjnë inspektimin e tyre. Pyetje për përfaqësuesin e AKMP-së: A ka ndonjë proces të ndonjë fabrike tjetër që e ka vizituar ky inspektorat, përveç Farmakosit? Kërkoj të më jepet kohë prej një deri në dy vjet (1-2), derisa të krijohen kushte për GNP-në. Duhet kohë dhe mjete, 1 deri në 2 milionë euro, për krijimin e kushteve dhe të standardeve të GNP-së, me kusht që inspektorët në çdo kohë të mund ta vizitojnë Farmakosin.

**Zehadin Gashi** - Tha se shumë ligje dhe udhëzime administrative që janë në fuqi nuk i plotësojnë kërkesat e Agjencisë dhe janë shumë të rrepta. Po të respektoheshin me përpikëri asnjë veprimtari nuk do të mund të ushtrohej në Kosovë. Farmakosi i është nënshtruar licencimit dhe në bazë të proceduarave juridike Agjencia i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, në të cilën është Inspektorati. Në raportin e parë, inspektorët i kanë dhënë disa vlerësime të paqarta, sepse raporti i tyre nuk ka pasur konstatim, a i plotëson apo jo prodhuesi kushtet për veprimtari? Sipas raportit prodhuesi nuk i plotëson kushtet e PMP-së. Me shkresë të veçantë i është drejtuar inspektorit, me të cilën ka kërkuar konstatimin se a i plotëson prodhuesi kushtet për zhvillimin e veprimtarisë? Përgjigjja ishte e njëjtë. Pastaj i është drejtuar edhe ministrit me një rekomandim që të krijohet një komision tre anëtarësh për ta bërë vlerësimin e kësaj çështjeje. Nëse kërkohet mendimi i tij personal, me këto ligje në fuqi, nuk ka zgjidhje për Farmakosin.

**Teuta Hadri** – Tha se nuk është në kompetencën e Komisionit të vendosë për këtë çështje. Pronari është dashur t’u drejtohej organeve kompetente gjyqësore. Komisioni edhe në mandatet e kaluara, asnjëherë nuk është njoftuar për privatizimin e kësaj fabrike, domethënë, Komisioni nuk ka të dhëna as për çmimin që pronari e pagoi për këtë kompani.

**Sadik Idriz** – Komisioni pas diskutimeve të shumta ka vendosur të dëgjojen përfaqësuesit e të dyja palëve për këtë rast. Komisioni nuk mund të ndërhyjë në fushën e ekzekutivit, por mund ta japë një sugjerim për këtë çështje.

**Mimoza Ahmetaj** – E pyeti përfaqësuesin e AKPM-së: Në Kosovë ka shumë produkte farmaceutike nga shtetet e rajonit, të gjitha kompanitë a e kanë të vërtetuar PMP-në? A ka mundur Agjencia t'i vërtetonte këto produkte farmaceutike që janë në Kosovë? A është i kualifikuar dhe i trajnuar Inspektorati për inspektimin e specifikave? Ju, personalisht, z. Gashi nuk keni qenë i pajtimit ta shkruani këtë rekomandim për Farmakosin, apo jo?

**Armend Zemaj** – Lidhur me kompetencën ose jo të Komisionit për ta shqyrtuar këtë çështje, tha se si deputetë duhet të merremi me çështjet që i preokupojnë qytetarët tanë dhe me zbatimin e ligjeve që i miraton Kuvendi. Komisioni e ka shqyrtuar me seriozitet këtë ankesë. E kam shfrytëzuar të drejtën e qasjes në dokumente zyrtare për ta marrë tërë lëndën e “New-Co Farmakosit” nga Ministria e Shëndetësisë, domethënë sipas kërkesave të para që janë bërë në vitet 2005, 2007 dhe 2008. Sipas dokumentacionit nuk ka diçka tendencioze. Sipas direktivave të BE-së prodhuesve farmaceutikë u është dhënë kohë t'i përshtatin kushtet e prodhimit. Nga dokumentacioni që kam marrë shihet disa herë se ju është dhënë kohë. Që nga viti 2005 e keni përsëritur kërkesën dhe përsëri, pas inspektimit, nuk i keni plotësuar kushtet e kërkuara. Është fat që deri më tani nuk ka pasur ankesë nga askush se ndonjë nga produktet e Farmakosit ka shkaktuar ndonjë kundërrindikacion. Ne si deputetë e kemi për detyrë ta mbikëqyrim zbatimin e Ligjit. Nga dokumentacioni, del se Agjencia e ka kryer punën e vet si duhet. Ajo për të cilën duhet të mendojmë, është: Si ta ndihmojmë prodhuesin vendor t'i plotësojë këto kritere?

**Qamile Morina** – Tha se në AKPM ka shumë keqpërdorime dhe shkelje të Ligjit. Sa i përket transparencës, pozita i ka në dispozicion të gjitha materialet për të cilat është e interesuar, kurse asaj i është refuzuar kërkesa për qasje në dokumente zyrtare. Udhëzimi administrativ nr. 2008/04, i nxjerrë nga AKPM-ja, është në kundërshtim të plotë me Ligjin. Sipas Ligjit produktet farmaceutike, të prodhuara edhe në vend, duhet ta kenë GNP-në (cilësinë e produktit), ndërsa sipas Udhëzimit nr. 2008/04 produktet farmaceutike nuk duhet ta kenë GNP-në. 70% e ligjeve në Kosovë nuk po zbatohen. Ajo kërkoi nga kryeshefi i AKPM-së premtimin - t'i lejohet qasja në dokumente zyrtare, si deputete.

**Flora Brovina** – Tha, edhe pse Komisioni nuk ka kompetencë për të vendosur për këtë çështje, megjithatë ka insistuar që ky problem duhet të trajtohet dhe duhet të dëgjojen palët. Ky problem i takon fushës së shëndetësisë, që e mbulon ky komision, sidomos duke u nisur nga fakti se barnat janë ato që po sjellin probleme në shëndetësi - mungesa e tyre. Komisioni nuk duhet të merret me dokumentacionin, sepse është Ministria ajo që duhet ta bëjë këtë. Dokumentet nuk duhet ta pengojnë zhvillimin e këtij institucioni, sepse është i vetmi dhe shumë i rëndësishëm. Kjo fabrikë duhet të ndihmohet dhe të favorizohet në raport me produktet që merren nga vendet e tjera pa kurrfarë kontrolli. Komisioni nuk merret me produktet, por me politikat. Meqenëse merret me politikat, Komisioni është i interesuar që të kemi produktet tona farmaceutike. Duhet të diskutojmë si t'i ndihmojmë kësaj kompanie. Nuk duhet të vuajmë nga aktet administrative që janë nganjëherë shumë të ngarkuara, madje edhe kontradiktore njëra me tjetrën, sepse realiteti është shumë më praktik.

**Gjynaze Syla** – Tha se e ka përkrahur idenë që të dëgjojen të dy palët për të marrë njoftime, sepse si deputetë e kemi për detyrë ta përcjellim sa po zbatohet Ligji. Nëse vërejmë se Ligji nuk po zbatohet, atëherë si Komision i përkrahim ndryshimet e ligjeve. Vlerësojmë se cilat ndryshime duhet të bëhen në Ligj, si dhe marrim të dhëna nëse është e qartë se Ligji duhet të ndryshohet.

Si deputete ajo ndihet përgjegjëse për 50 punëtorët që punojnë në këtë fabrikë. Parashtrroi pyetje për përfaqësuesin e AKPM-së: Nëse i vazhdohet licenca Farmakosit, cilat janë rreziqet që mund të jenë si pasojë e saj? A mund ta përcjellë Agjencia për dy vjet punën e Farmakosit që të mos ngjajë ndonjë pasojë ose rrezik i mundshëm për shëndetin e qytetarëve? Pyetja për z. Lajçi ishte: Pse është i sigurt se për dy vjet do t'i plotësojë kushtet e kërkuara për GNP-në?

**Rita Hajzeraj** - Tha se ka qenë nismëtare e këtij takimi, që Komisioni të merrte të dhëna për këtë resor farmaceutik, që është resor i shëndetësisë. Komisioni e ka për detyrë ta mbikëqyrë punën e këtyre resorëve. Nuk është i vetmi deputeti Armend Zemaj, që e ka marrë lëndën nga Ministria e Shëndetësisë, sepse atë lëndë e ka marrë edhe ajo. Nga dokumentacioni shihet se Farmakosi në krahasim me vitet paraprake, në vitet 2007 dhe 2008 ka ndryshime. E pyeti z. Gashi: Stafi që e ka kontrolluar Farmakosin, a është staf profesionist për PMP-në, apo në bazë të cilave kriteret është marrë vendimi të mos licencohet kjo firmë? Vendimi i AKPM-së është bazuar në udhërrëfyesin e OBSH-së, sa janë obligative kriteret e udhërrëfyesit të OBSH për licencim? Kurse pyetja e saj për z. Lajçi ishte: A ndodh që barnat tuaja të blihen nga farmacitë e tjera, apo nga blerësit e tjerë dhe të shiten te Ministria e Shëndetësisë?

**Nurishahe Hulaj** – Tha se Kosova ka pasur shumë pak farmacistë. Tani është në rrugën të mirë që t'i plotësojë disa kriteret dhe standarde që një barnatore e Kosovës ta ketë një farmacist. Duhet ta kemi parasysh se të gjithë jemi të interesuar që Kosova të ketë prodhime vendore. Farmakosi ka traditë. Kjo fabrikë mund të futet në kanalet e prodhimit dhe duhet ta përkrahim. Po ashtu, duhet të merret parasysh fakti se kjo fabrikë i ka të punësuar 50 punëtorë. Është shumë me rëndësi që këta punëtorë të mos mbeten në rrugë.

**Sadik Idriz**- E pyeti z. Lajçi: A ka marrë Farmakosi deri më tani ndonjë formë të ndihmës nga institucionet shtetërore si prodhues vendor? Pyetje për z. Gashi: Cilat produkte medicinale hyjnë në Kosovë? A e kontrollon AKPM-ja gjithë territorin e Kosovës? A konsideroni se Farmakosi është i vetmi problem në Kosovë?

**Zehadin Gashi** – Tha se në kohën kur e ka filluar punën ishte ballafaquar me pengesa nga institucionet më të ulëta e deri tek ato më të lartat. Për 7 muaj aparaturat me vlerë 7 milionë euro kanë qëndruar në korridor. Tani ato aparatura janë funksionale. Për tre vjet dhjetë punëtorë kanë marrë paga pa punuar fare. Asnjë qytetar nuk ka mund të kryejë punë, nëse nuk ka dhënë rryshfet. Trajnime nuk janë bërë deri më tani. Tha se e ka dërguar një organogram te ministri për nënshkrim me të cilin ka kërkuar të organizohej një inspektorat profesional.

**Mimoza Ahmetaj** – Pyeti: A do të thotë kjo se raporti i lëshuar nga Inspektorati është jovalid, duke marrë parasysh se ky inspektorat nuk është shumë profesional?

**Zehadin Gashi** – Tha se inspektorët nuk kanë trajnime për GNP-në. GNP-ja është një fushë e gjer, me të cilën nuk mund të merremi për një muaj, as për një vit. Fatmirësisht në këtë vit Agjencia e ka marrë një donacion për binjakëzimin e agjencive dhe shpreson se çdo degë e AKPM-së do të aftësohet për punën që e bën. Agjencia nuk mund ta bëjë kontrollin në firmat rajonale që kanë produkte medicinale të licencuara në Kosovë, sepse nuk ka inspektor të akredituar, por është një komision mbikëqyrës që mund t'u drejtohet fabrikave për të cilat dyshohet se u mungon cilësia. Kontrolli i barnave është duke u bërë në mënyrë sistematike. Para se të miratohej Udhëzimi administrativ 2008/4, prania e barnave të rajonit ka qenë në proporcion 25% të Bashkësisë Evropiane dhe 75% të vendeve të rajonit. Udhëzimi administrativ 2008/4 e ka kthyer gjendjen në proporcion të kundërt.

**Qamile Morina** – Tha se pyetja e saj kishte të bënte vetëm me nenin e PMP-së.

**Azem Lajçi** – Lidhur me kompetencën ose jo të Komisionit për ta shqyrtuar këtë çështje, tha se i është drejtuar Kuvendit si organi më i lartë i shtetit. Këtu janë dy çështje: A doni ta zbatoni ligjin dhe çështja e dytë, a doni të na ndihmoni? Vendimi që është lëshuar nga AKPM-ja është tërësisht kundërligjor. Në të thuhet se „Farmakosi” nuk i plotëson kushtet e GNP-së, ndërsa në Ligj thuhet se duhet të plotësohen kushtet e GNP-së sipas aktit plotësues normativ. Akti normativ nuk ekziston. Cilat kushte duhet t'i plotësoj, nuk e di? Shtetet transitore si Kosova, kanë marrë sugjerime, propozime e rekomandime nga OBSH-ja. Tani jemi shtet dhe i kemi ligjet tona, OBSH - ja nuk është më obligative për ne. Edhe ne kemi dëshirë ta kemi GNP-në, por tani për tani nuk kemi mundësi. Shteti nuk më ka ndihmuar asgjë. 300 mijë euro i paguaj tatim çdo vit shtetit. Kam të punësuar 50 punëtorë, që pesë muajt e fundit i paguaj pa punuar fare, për shkak të mos rilicencimit. Raporti i Inspektoratit është tendencioz, sepse në të thuhet se fabrika është e vendosur në afërsi të banimit me mundësi të ndotjes së ambientit. Kjo mundësi nuk ekziston, sepse Farmakosi nuk e lëshon asnjë substancë ndotëse.

**Teuta Hadri** - Pyeti se ku i leni materialet plastike, kimikatet etj.

**Azem Lajçi** - Tha se ekziston bunker i posaçëm për këto lloje mbeturinash të preparateve. Farmakosi nuk krijon ndotje të ambientit, por problemi për moslicencim qëndron vetëm te GNP- ja. GNP- në nuk e kanë edhe shumë fabrika të tjera që kanë barna në tregun e Kosovës, si: Alkaloidi, Jaka, Pliva, Radovishta, Profarma etj .

GNP-në, dëshiroj ta kem sa më parë që të jetë e mundur, por mendoj se afati prej dy vjetësh është i mjaftueshëm që ta bëj këtë. Mund të them se asnjë preparat nuk e qes në treg pa ia bërë analizat. Do të duhej që të gjitha barnat që i prodhon Farmakosi të hyjnë në barnat e listës esenciale, por Ministria në asnjë tender nuk na ka marrë parasysh edhe pse kemi qenë 30% më të lirë.

Unë kam obligim ndaj 50 punëtorëve që i kam të punësuar. Kam marrë përgjigje nga ministri i Shëndetësisë se nuk i intereson për ata punëtorë.

**Armend Zemaj** - Tha se, në bazë të raportit të inspektorëve depoja nuk ka ndarje fizike për karantinë për lëndë të para, për substanca toksike ndezëse, nuk janë të përpiluar të gjithë regjistrat, nuk merren mostrat nga personat e autorizuar e shumë e shumë të tjera.

**Azem Lajçi** - Tha se mund t'ju dëshmoj se të gjitha ato që janë në raportin e Inspektoratit nuk janë të vërteta dhe ju vetë mund ta vizitoni fabrikën tonë.

**Sadik Idriz** - Tha se duhet të ndihmohen kompanitë vendore dhe duhet t'i japim edhe një afat të arsyeshëm Farmakosit. Komisioni mund ta vizitojë këtë kompani. Këtë vit është paraparë edhe amendamenti i Ligjit për produkte medicinale dhe ndoshta Komisioni do ta vizitojë edhe AKPM-në. Komisioni nuk mund të marrë vendim për këtë çështje, por mund të bëjë vetëm rekomandime. Ndoshta dikush nga ne do të bisedojë me ministrin që t'i jepet kësaj kompanie edhe një afat shtesë, nëse jo, të veprohet sipas Ligjit dhe ankesa e Farmakosit të shqyrtohet nga Bordi i Ankesave.

**Gjylnaze Sylja** - Tha se është e qartë se Udhëzimi Administrativ për GNP-në mungon. Duhet të kërkohet nga Ministria e Shëndetësisë të nxirret ky udhëzim.

**Zehadin Gashi** - Tha se gjashtë udhëzime administrative i ka proceduar për miratim, por nuk e di se kur do të miratohen. Ka propozuar të formohet një komision nga Ministria, që do të shkonte për ta bërë vlerësimin në vendin e ngjarjes dhe për ta përshtatur me rrethanat e Ligjit, sepse Udhëzimi Administrativ nuk ekziston.

**Mimoza Ahmetaj** - Propozoi që në mbledhjet e tjera, kur Komisioni të ketë të ftuar, të mos ceket vazhdimisht se çfarë kompetencash ka Komisioni. Komisioni e di çka ka dhe çka nuk ka në kompetencë dhe nuk ka nevojë kjo të ceket para të tjerëve.

**Sadik Idriz** – Tha, vetëm sqarova cili është roli i Komisionit - që nuk është vendimmarrës, por vetëm nxjerr rekomandime, në mënyrë që të mos krijohet përshtypja se ne po bëjmë trysni në Ministri, por vetëm po përpiqemi të gjejmë zgjidhje.

#### **4. Të ndryshme**

##### **a) Diskutim për dëgjimin publik – mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për veprimtari private në shëndetësi**

**Sadik Idriz** - Tha se procesverbali i dëgjimit publik mbetet për miratim në mbledhjen e radhës, ndërsa propozimet me shkrim nga të ftuarit në dëgjim publik, të shqyrtohen në grupin e punës për zbatimin e Ligjit dhe të përgatiten rekomandimet.

**Teuta Hadri** - Tha se grupi i punës që e ka mbikëqyrë zbatimin e Ligjit, në mbledhjen e radhës duhet të dalë me konkluzione nga dëgjimi publik.

**Qamile Morina** - Sqaroi se në dëgjimin publik, kur ajo e ka parashtruar pyetjen për memorandumimin e nënshkruar ndërmjet ministrive, e ka pasur një reagim nga kolegët dhe nga Ministria, se memorandumimi nuk ishte nënshkruar. Ajo e ka siguruar atë memorandum, që është i nënshkruar.

**Sadik Idriz** - Tha se ai memorandum është i nënshkruar për të hyrat vetjake për kujdestari, por jo për të hyrat vetjake të licencimit.

##### **b) Diskutim rreth propozimit për fushëveprimtarinë e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

**Sadik Idriz** – E keni marrë edhe një propozim për fushëveprimtarinë e Komisionit. Ky fushëveprim do të jetë pjesë e Rregullores së re të punës të Kuvendit. Në atë propozim i keni edhe tri pika si propozime të reja. Hap diskutimin.

**Nurishahe Hulaj** - Propozoi të hiqet „do të”.

**Gjylnaze Sylja** - Propozoi që në pikën 6 të hiqet fjala „përcaktimin”, si dhe në pikën 7 të hiqet fjala „konceptimi”.

**Sadik Idriz** - Tha se deri në javën e ardhshme anëtarët e Komisionit mund të bëjnë propozime konkrete për fushëveprimtarinë e Komisionit.

##### **c) Propozim për vizitë në Klinikën e ORL-së të QKUK-së**

**Mimoza Ahmetaj** - Propozoi që një grup i Komisionit ta vizitojë Klinikën e ORL-së. Po flitet në media, nga të cilat jemi njoftuar se ka mungesë të materialit shpenzues. Në këtë vizitë më për së afërmi do të njoftohemi për situatën.

**Sadik Idriz** - Tha se e kemi marrë një shkresë, në të cilën Klinika e ORL-së, ka demantuar se nuk ka furnizim me barna.

**d) Propozim për vizitë në Onkologji dhe në Qendrën Diagnostike të QKUK-së**

**Qamile Morina** - Tha se të gjithë e dimë se janë hapur Onkologjia dhe Qendra Diagnostike. Krejt projekti për to ka kushtuar 5 milionë euro, por pas disa ditësh janë vërshuar nga uji. Propozoi t'i vizitojmë dhe të shohim se çfarë ka ndodhur dhe sa janë dëmet.

**Sadik Idriz** - Nëse Komisioni do të merrej me të gjitha çështjet që paraqiten në media, atëherë cilat do të jenë roli dhe kompetencat e Komisionit? Në emër të Komisionit duhet të punojmë dhe do të mund të vendosim në emër të tij, vetëm nëse votojmë si Komision.

**Rita Hajzeraj** - Tërhoqi vërejtjen të mos fyhet më nga deputetja Qamile Morina “*se nuk dihet, Rita a është pozitë apo opozitë*”. Kërkoj që kjo të mos përsëritet.

**Qamile Morina** - U përgjigj: Të kam thënë se je shumë afër pozitës.

**Armend Zemaj** - Tha se lidhur me Onkologjinë faji është te gypat e ujit dhe nuk kemi pse të shkojmë në vizitë.

**Qamile Morina** - Tha se edhe para shpërthimit të ujit në Qendrën e porsahapur nuk kishte asnjë pacient.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

*E përgatiti:*

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz